



BASHKIA LEZHË

---

## MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

**Z. PJERIN NDREU**



RISHIKIM I PLANIT TE DETYRUAR VENDOR (PDyV) PËR  
ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 2, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
LEZHË, BASHKIA LEZHË

Shkurt 2021

RISHIKIM I PLANIT TË DETYRUAR  
VENDOR (PDyV) PËR ZONËN E RE  
TË ZHVILLIMIT 2, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE LEZHË, BASHKIA  
LEZHË

Shkurt 2021

## 1. Hyrje

Pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Qeveria Shqiptare mori nismën për të mbështetur bashkitë e prekura, përmes një plani për rindërtim dhe mëkëmbje sociale.

Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", parashikon strukturimin e procesit të rindërtimit nga planifikimi i territorit përmes Planit të Detyruar Vendor (PDyV); një instrument që hartohet për një zonë të veçantë, të shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave, si Zonë e Re për Zhvillim (ZRZh), e cila mund të jetë një zonë e dëmtuar, ose një territor i lirë nga ndërtimet, apo i përshtatshëm për procesin e rindërtimit.

Qeveria shqiptare ka caktuar, nga Fondi i Rindërtimit, një fond të posaçëm për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe ka ngarkuar Agjencinë e Planifikimit të Territorit si njësi zbatuese për hartimin e PDyV-ve, mbi bazën e VKM nr.9, datë 10.01.2020, "Për caktimin e njësive zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga Fondi për Rindërtimin miratuar në Buxhetin e vitit 2020".

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, më datë 07 Shkurt, të vitit 2020, miratoi propozimin për caktimin e Zonave 1 dhe 2, përkatësisht 3.5 ha dhe 9.5 ha, në Njësinë Administrative Lezhë, Bashkia Lezhë si Zonë e Re për Zhvillim. Në vijim të tekstit zonave do t'u referohemi me akronimet :ZRZh\_LE\_1 dhe ZRZh\_LE\_2



Figura 1. ZRZh\_LE\_2 – gjendja aktuale-kufi i zonës



